



REPUBLIKA E KOSOVËS - РЕПУБЛИКА КОСОВО - REPUBLIC OF KOSOVO  
**GJYKATA KUSHTETUESE**  
**УСТАВНИ СУД**  
**CONSTITUTIONAL COURT**

Prishtinë, më 6 shkurt 2017  
Nr. ref.: RK 1035/17

## AKTVENDIM PËR PAPRANUESHMËRI

në

**rastin nr. KI113/15**

Parashtrues

**Ramë Ramaj**

**Vlerësim i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Gjykatës Supreme të Republikës së Kosovës, Rev. nr. 80/2014, të 14 prillit 2014**

## **GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS**

e përbërë nga:

Arta Rama-Hajrizi, kryetare  
Ivan Čukalović, zëvendëskryetar  
Altay Suroy, gjyqtar  
Almiro Rodrigues, gjyqtar  
Snezhana Botusharova, gjyqtare  
Bekim Sejdiu, gjyqtar  
Selvete Görxhaliu-Krasniqi, gjyqtare  
Gresa Caka-Nimani, gjyqtare

### **Parashtruesi i kërkesës**

1. Kërkesa është dorëzuar nga Ramë Ramaj (në tekstin e mëtejmë: parashtruesi i kërkesës), me vendbanim në Ferizaj.

## **Vendimi i kontestuar**

2. Parashtruesi i kérkesës konteston Aktgjykimin e Gjykatës Supreme, Rev.nr. 80/2014, të 14 prillit 2014 (në tekstin e mëtejmë: vendimi i kontestuar) lidhur me padinë e iniciuar nga ai për konflikt administrativ.
3. Vendimi i kontestuar i është dorëzuar parashtruesit të kérkesës më 7 gusht 2015.

## **Objekti i çështjes**

4. Objekt i çështjes është kérkesa për vlerësim të kushtetutshmërisë së vendimit të kontestuar të Gjykatës Supreme, me të cilin pretendohet shkelja e nenit 21 [Parimet e Përgjithshme], nenit 22 [Zbatimi i Drejtpërdrejtë i Marrëveshjeve dhe Instrumenteve Ndërkombëtare] dhe nenit 24 [Barazia para Ligjit] të Kushtetutës së Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Kushtetuta).

## **Baza juridike**

5. Kérkesa bazohet në nenin 113.7 të Kushtetutës dhe në nenin 47 të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës, nr. 03/L-121 (në tekstin e mëtejmë: Ligji).

## **Procedura në Gjykatën Kushtetuese**

6. Më 1 shtator 2015, parashtruesi i kérkesës e dorëzoi kérkesën në Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Gjykata).
7. Më 14 tetor 2015, Kryetarja e Gjykatës caktoi gjyqtaren Snezhana Botusharova gjyqtare raportuese dhe Kolegjin shqyrtares, të përbërë nga gjyqtarët: Altay Suroy (kryesues), Bekim Sejdiu (anëtar) dhe Arta Rama-Hajrizi (anëtar).
8. Më 13 nëntor 2015, Gjykata njoftoi parashtruesin për regjistrimin e kérkesës dhe një kopje të kérkesës ia dërgoi Gjykatës Supreme. Ndërsa, po të njëjtën ditë, nga Gjykata Themelore në Ferizaj kerkoi fletekthesën për pranimin e vendimit përfundimtar nga ana e parashtruesit të kérkesës.
9. Më 14 shtator 2016, Kolegji shqyrtares shqyrtoi raportin e gjyqtarit rapportues dhe i rekomandoi Gjykatës, në përbërje të plotë, që ta deklarojë kérkesën të papranueshme, si qartazi të pabazuar.

## **Përbledhja e faktave të rastit**

*Faktet lidhur me procedurën administrative*

10. Më 3 janar 2006, parashtruesi nënshkroi kontratë pune me Drejtorinë Komunale për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale të Ferizajt (në tekstin e mëtejmë: punëdhënësi), si punëtor i sigurimit pranë Qendrës Kryesore të Mjekësisë Familjare në Ferizaj.

11. Më 15 nëntor 2006, punëdhënësi e njoftoi parashtruesin për mosvazhdimin e kontratës së punës.
12. Në një datë të paspecifikuar, parashtruesi paraqiti ankesë në Komisionin për Ankesa të Kuvendit të Komunës së Ferizajt (në tekstin e mëtejmë: KAKK Ferizaj).
13. Më 12 janar 2007, KAKK në Ferizaj me Vendimin nr. 07/8638-08 refuzoi si të pa bazuar ankesën e parashtruesit të kërkesës.
14. Ndaj këtij Vendimi parashtruesi u ankua në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbysit Civil të Kosovës (në tekstin e mëtejmë: KPMSHC).
15. Më 30 mars 2007, KPMSHC refuzoi si të pabazuar ankesën e parashtruesit dhe la në fuqi vendimin e KAKK të Ferizajt.

*Faktet lidhur me procedurën gjyqësore*

16. Parashtruesi, ndaj Vendimit të KPMSHC, parashtrroi padi për konflikt administrativ në Gjykatën Supreme.
17. Më 18 korrik 2007, Gjykata Supreme hodhi poshtë padinë e parashtruesit dhe lëndën ia dërgoi Gjykatës Komunale të Ferizajt, për të vodosur si gjykatë kompetente.
18. Më 18 shtator 2012, Gjykata Komunale në Ferizaj (Aktvendimi C. nr. 548/07), hodhi poshtë padinë e parashtruesit për shkak të ushtrimit të saj jashtë afatit ligjor.
19. Parashtruesi i kërkesës ushtroi ankesë ndaj Aktvendimit në Gjykatën e Apelit në Prishtinë.
20. Më 30 dhjetor 2012, Gjykata e Apelit, me Aktvendimin Ac. nr. 4753/12, e shpalli ankesën e parashtruesit si pjesërisht të pranueshme, duke e ndryshuar vendimin e gjykatës së instancës së parë sa i përket aplikimit të ligjit material. Si përfundim, Gjykata e Apelit vodosi që padinë e parashtruesit në tërësi ta hedhë poshtë si të paafatshme.

*Faktet lidhur me mjetin juridik të jashtëzakonshëm*

21. Në një datë të paspecifikuar, parashtruesi paraqiti kërkesë për revizion në Gjykatën Supreme.
22. Më 14 prill 2014, Gjykata Supreme, me Aktvendimin Rev. nr. 80/2014, refuzoi si të pabazuar kërkesën e parashtruesit për revizion dhe la në fuqi Aktvendimin e Gjykatës së Apelit.
23. Për më tepër, Gjykata Supreme arsyetozi si në vijim:

*“Në rastin konkret paditësi padinë në gjykatë e ka paraqitur pas afatit të parashikuar me ligjet e lartpërmendura për arsyen se padia në gjykatë*

*është paraqitur me datën 22.5.2007, ndërsa aktvendimin përfundimtar e ka pranuar me datë 11.4.2007.*

*Sipas vlerësimit të Gjykatës Supreme, gjykatat e instancës më të ulët drejtë kanë zbatuar dispozitën e nenit 83 të LPTHMPJ, për arsyen se ky afat është prekluziiv dhe pas skadimit të këtij afati punëtori e humb të drejtën e mbrojtjes gjyqësore, prandaj padia e paraqitur pas këtij afati doemos duhet të hedhet poshtë si e paafatshme, andaj Gjykata Supreme e Kosovës vlerëson se aktvendimi i gjykatës së shkallës së dytë është i drejtë dhe i ligjshëm”.*

### **Pretendimet e parashtruesit të kërkesës**

24. Parashtruesi i kërkesës pretendon se i janë shkelur të drejtat kushtetuese të garantuara në Kapitullin II, respektivisht me nenin 21, 22 dhe 24 të Kushtetutës.
25. Parashtruesi, mes tjerash, pretendon se gjykata e instancës së parë dhe ajo e instancës së dytë morën vendim në kundërshtim me dispozitat e nenit 224 të Ligjit mbi Punën e Bashkuar, për arsyen se të njëjtat gabimisht interpretuan dispozitat e këtij ligji.
26. Parashtruesi kërkon që Gjykata ta deklarojë kërkesën e tij të bazuar dhe t'i anulojë vendimet e të gjitha gjykatave lidhur me rastin e tij, duke përfshirë edhe vendimet administrative.

### **Pranueshmëria e kërkesës**

27. Gjykata do të shqyrtojë nëse parashtruesi i kërkesës i ka plotësuar kriteret për pranueshmëri, të përcaktuara me Kushtetutë dhe të specifikuara më tej në Ligj dhe në Rregullore të punës.

28. Së pari, Gjykata i referohet nenit 113.7 të Kushtetutës, që përcakton:

*“Individët janë të autorizuar të ngrenë shkeljet nga autoritetet publike të të drejtave dhe lirive të tyre individuale, të garantuara me Kushtetutë, mirëpo vetëm pasi të kenë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj”.*

29. Gjykata më tej i referohet nenit 48 të Ligjit, që parasheh:

*“Parashtruesi i kërkesës ka për detyrë që në kërkesën e tij të qartësoj saktësisht se cilat të drejta dhe liri pretendon se i janë cenuar dhe cili është akti konkret i autoritetit publik të cilin parashtruesi dëshiron ta kontestojë”.*

30. Gjykata, po ashtu, merr parasysh rregullin 36 (1) (d) dhe rregullin 36 (2) (b) të Rregullores së punës, i cili parasheh:

*“(1) Gjykata mund ta shqyrtojë një kërkesë nëse:*

*(...)*

(d) kérkesa arsyetohet prima facie ose nuk është qartazi e pabazuar.

(2) Gjykata do të deklarojë një kérkesë si qartazi të pabazuar, nëse bindet se:

(...)

(b) faktet e paraqitura në asnjë mënyrë nuk e arsyetojnë pretendimin për shkeljen e një të drejte kushtetuese".

31. Gjykata vëren se, parashtruesi i kérkesës pretendon shkelje të nenit 21, 22 dhe 24 të Kushtetutës. Ai konsideron se këto shkelje kushtetuese burojnë nga refuzimi i shqyrtimit të padisë për konflikt administrativ nga gjykatat e rregullta.
32. Në lidhje me këto pretendime, Gjykata vëren se të gjitha instanca të ndryshme gjyqësore, përfshirë edhe Gjykatën Supreme, që u morën me rastin e parashtruesit, e hodhën poshtë si të pabazuar padinë e tij për konflikte administrative për shkaqe procedurale, respektivisht për shkak të parashtrimit të padisë në fjalë, pas afatit ligjor prej 30 (tridhjetë) ditësh.
33. Për më tepër, Gjykata vëren se parashtruesi i kérkesës vetëm i përmend dispozitat kushtetuese të garantuara në Kapitullin II të Kushtetutës, pa argumentuar se si janë shkelur ato dispozita konkrete të Kushtetutës në rastin e tij, ashtu siç kërkon neni 48 i Ligjit.
34. Përveç kësaj, parashtruesi pretendon se gjykatat e rregullta interpretuan në mënyrë të gabuar dispozitat e ligjit material, respektivisht nenin 224 të Ligjit mbi Punën e Bashkuar.
35. Përkitazi me këtë, Gjykata thekson se një pretendim i tillë është i natyrës së ligjshmërisë dhe çështjet e ligjshmërisë janë në domenin e gjykatave të rregullta.
36. Gjykata Kushtetuese vëren se sipas Kushtetutës, nuk është detyrë e saj të veprojë si gjykatë e shkallës së katërt në lidhje me vendimet që merren nga gjykatat e rregullta. Është roli i gjykatave të rregullta që të interpretojnë dhe të zbatojnë rregullat përkatëse të së drejtës procedurale dhe materiale (Shih rastin *Garcia Ruiz kundër Spanjës*, Nr. 30544/96, GJEDNJ, Aktgjykimi i 21 janarit 1999, shih gjithashu rastin KI70/11, parashtrues të kérkesës *Faik Hima, Magbule Hima dhe Bestar Hima*, Aktvendim për papranueshmëri, i 16 dhjetorit 2011).
37. Në juridikcionin e Gjykatës është të vërtetojë nëse, në përgjithësi, procedurat në gjykatat e rregullta kanë qenë korrekte dhe të drejta në tërësi (Shih, ndër të tjera, rastin *Edwards kundër Mbretërisë së Bashkuar*, Nr. 13071/87, Raport i Komisionit Evropian për të Drejtat e Njeriut, i 10 korrikut 1991).
38. Fakti i thjeshtë se parashtruesi është i pakënaqur me rezultatin e rastit, nuk do të thotë që ai mund të ngre një kérkesë të pranueshme dhe të justifikueshme, duke pretenduar shkeljen e të drejtave të tij/saj, të mbrojtura me Kushtetutë dhe KEDNJ.

39. Në këto rrethana, Gjykata konsideron se faktet e paraqitura nga parashtruesi i kërkesës në asnjë mënyrë nuk tregojnë se gjykatat e rregullta ia kanë mohuar atij të drejtat e garantuara me Kushtetutë, respektivisht të drejtat e garantuara me nenin 21, 22 dhe 24 të Kushtetutës.
40. Rrjedhimisht, kërkesa është qartazi e pabazuar në baza kushtetuese dhe duhet të deklarohet e papranueshme në pajtim me rregullin 36 (1) (d) dhe 36 (2) (b) të Rregullores së punës.

### **PËR KËTO ARSYE**

Gjykata Kushtetuese, në mbështetje të nenit 113.7 të Kushtetutës, të neneve 20 dhe 48 të Ligjit dhe të rregullave 36 (1) (d) dhe 36 (2) (b), si dhe 56 (2) të Rregullores së punës, më 6 shkurt 2017, njëzëri

### **VENDOS**

- I. TA DEKLAROJË kërkesën të papranueshme;
- II. T'UA KUMTOJË këtë vendim palëve;
- III. TA PUBLIKOJË këtë vendim në Gazetën Zyrtare, në pajtim me nenin 20.4 të Ligjit;
- IV. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

**Gjyqtarja raportuese**

Snezhana Botusharova

**Kryetarja e Gjykatës Kushtetuese**

Arta Rama-Hajrizi

